



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401552/2

Tiranë ____/____/2014

Lënda: *Rekomandojmë rillogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë të shtetasit D.B.*

Drejtuar: **Z. Arsim RAMA**
Drejtorit të Drejtorisë Rajonale
të Sigurimeve Shoqërore

TIRANË

I nderuar zoti Rama,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi D.B. në përmbajtjen e së cilës ankohet për masën e ulët të pensionit të pleqërisë dhe kërkon rillogaritjen e pensionit të pleqërisë.

Sipas shpjegimeve të tij, ankuesi ka dalë në pension pleqërie më datë 04.07.2003 në moshën 55 vjeç. Pavarësisht se ka përfituar të gjitha shtesat të bëra në vite sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave, masa e pensionit të tij, ka arritur në shumën e 14400 lekë në muaj.

Ankuesi pretendon se bazuar në vjetërsinë e përgjithshme të punës së tij, nga të cilat, për 22 vjet ka punuar në Uzinën e Armatimit, Poliçan, në tunel, masa e pensionit të tij duhet të ishte më e lartë dhe ka kërkuar ndërmjetësimin tonë institucional për të mundësuar rillogaritjen e pensionit të tij të pleqërisë, pasi nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Libreza e Pensionit është me nr.145318/I.

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se : "Paraqet

rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

Rillogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë të shtetasit D.B.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet shprehimisht se: *“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,*

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI